



**“ALTER - Active Local Territories for Economic development of Rural Areas - TALER**  
**Territoret Aktive Lokale për zhvillimin**  
**Ekonomik të Zonave Rurale”**  
**PROGRAMI I GRANTIT**



Nr.  
Data  
Vendi

Grantdhënësi **XXX**, me adresë: **XXX**, numri i regjistrimit **XXX**, NIPT **XXX**, përfaqësuar nga **XXX**, Drejtori Ekzekutiv, në emër të Projektit ALTER, si grantdhënësi (që në këtë dokument do të jetë shkurtimi i organizatës zbatuese **XXX**),

dhe

(Emri i organizatës) me adresë: "**XXX**" Nr., kodi postar, qyteti, numri i regjistrimit **XXX**, NIPT, nr. i llogarisë bankare **XXX** (banka: emri, qyteti), përfaqësuar nga....., pozicioni i personit të autorizuar, si përfituesi i grantit (që në këtë dokument do të referohet si: përfituesi).

## KONTRATË GRANTI

### ALTER

## Objekti i kontratës

### Neni 1

Kjo marrëveshje përcakton të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta midis grantdhënësit dhe përfituesit në lidhje me zbatimin e Projektit ALTER (që në këtë dokument do të referohet si Projekti).

Zbatimi i Projektit është pjesë e Marrëveshjes së Granteve në kuadër të Projektit ALTER, financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti ALTER po vihet në zbatim nga Rrjeti për Zhvillim Rural i Serbisë, si partneri kryesor si dhe nga organizatat e tjera partnere: Rrjeti për Zhvillim Rural i Bosnjë-



**Ky dokument është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Rrjetit për Zhvillimin Rural të Serbisë dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian.**

Hercegovinës, Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural në Kosovë, Rrjeti për Zhvillim Rural në Maqedoni, Rrjeti për Zhvillim Rural në Malin e Zi, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim – Shqipëri, Fondacioni për Zhvillim në Turqi, Forumi Rural i Letonisë, Rrjeti Kroat për Zhvillim Rural. Përfituesit i akordohet granti sipas aplikimit që ka bërë, pas vlerësimit të kryer nga Komisioni i Vlerësimit për CfA # ALTER i Projektit ALTER të shpallur në xx Nëntor 2017.

Projekti i miratuar së bashku me buxhetin përkatës janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate. (Shtojca 1 – Formulari i Aplikimit dhe Shtojca 2 – Buxheti).

### **Zbatimi i Projektit**

Zbatimi i projektit do të fillojë në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate dhe do të zgjasë deri në \_\_\_\_\_.

Përfituesi e pranon këtë grant dhe do të marrë përgjegjësinë për realizimin me sukses të aktiviteteve të planifikuara sipas dokumentacionit të projektit të miratuar.

Për zbatimin e këtij Projekti aplikohen edhe rregullat e Guidës Praktike të BE-së.

## **Financimi i Projektit**

### Neni 2

Vlera totale e shpenzimeve të pranueshme llogaritet deri në <EUR> <shuma, për grantet e veprimt, vendos shumën në Shtojcën 2 >, siç përcaktohen në Shtojcën 2.

Ofruesi i grantit merr përsipër financimin e një shume maksimale prej <EUR .....>

Shuma përfundimtare e kontributit të Autoritetit Kontraktues do të vendoset në përputhje me shpenzimet e pranueshme reale të miratuara duke u bazuar në raportin financiar përfundimtar.

Granti do të ndahet në dy/tre këste:

#### **Për grantet deri në 5.000 EUR**

- **Kësti i parë**– 80% e grantit: 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës;
- **Kësti i dytë**– 20% e grantit: pas miratimit të raportit narrativ dhe raportit financiar;

#### **Për grantet midis 5.001 EUR dhe 17.000 EUR;**

- Kësti i parë – 50% e grantit: 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës;
- Kësti i dytë – 35% e grantit: 15 ditë pas nënshkrimit të narrativit të përkoshëm dhe raportit financiar;
- Kësti përfundimtar – 15% e grantit: pas miratimit të raportit narrativ dhe raportit financiar;

Lëvrimi i grantit do të kushtëzohet nga realizimi i pagesave të mëparshme dhe nga dinamika e aktiviteteve për periudhën pasuese.

Mosrespektimi i afateve të përcaktuara në Nenin 3 mund të sjellë si rezultat vonesën e pagesës. Nëse gjatë zbatimit evidentohen parregullsi kontrata do të ndërpritet.

## Paraqitja e raporteve

### Neni 3

Përfituesi ka detyrimin të dorëzojë narrativa të ndërmjetme dhe përfundimtare dhe raportin financiar për ecurinë e progresit, raporte që do të jenë sipas formatit të dhënë nga grantdhënësi.

Raporti i parë i ndërmjetëm narrativ duhet të dorëzohet jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të tremujorit të parë nga data e nënshkrimit të Kontratës.

Raporti i dytë i ndërmjetëm narrativ dhe raporti i parë financiar duhet të dorëzohen jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të pesë muajve nga data e nënshkrimit të Kontratës.

Raporti përfundimtar narrativ dhe financiar i projektit do të dorëzohet brenda 20 ditëve nga data e përfundimit të zbatimit të projektit. Brenda 15 ditëve nga miratimi i raportit përfundimtar, Grantdhënësi është i detyruar të transferojë fondet e mbetura tek përfituesit.

Grantdhënësi është i detyruar të shqyrtojë raportet e paraqitura. Grantdhënësi ka të drejtën të kërkojë që përfituesit të paraqesin informacione apo dokumente shtesë nëse shihet e nevojshme.

Gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit, grantdhënësi ka të drejtë të bëjë vizita të papritura tek përfituesi si pjesë e procesit të monitorimit dhe vlerësimit.

## Procedura për ndryshimet e bëra në aktivitetet dhe buxhetin e Projektit

### Neni 4

Për çdo ndryshim në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të projektit në përputhje me Shtojcën 1 dhe 2 të kësaj kontrate, përfituesi është i detyruar të kërkojë miratimin me shkrim nga stafi përkatës i Grantdhënësit.

Përfituesi mund të bëjë rishpërndarje të burimeve financiare nga një zë i buxhetit në një tjetër për një shumë jo më të madhe se 10% e shumës së përgjithshme të zërit përkatës. Rishpërndarja mes kategorive të buxhetit lejohet nëse kjo rishpërndarje nuk ka të bëjë me kategorinë e burimeve njerëzore dhe nëse rishpërndarja nuk është më e lartë se 25% e shumës totale të zërit në të cilën rishpërndahen burimet dhe nuk është më e lartë se 25% e shumës totale të kategorisë nga e cila rishpërndahen burimet.

Ndryshimet nuk mund të hyjnë në fuqi deri sa përfituesi të ketë marrë konfirmimin zyrtar me shkrim nga Grantdhënësi për vendimin përfundimtar në lidhje me ndryshimet e kërkuara.

Grantdhënësi është i detyruar që brenda 7-10 ditë pune të shqyrtojë kërkesën për ndryshimin e buxhetit dhe të marrë vendimin përfundimtar. Pas marrjes së këtij vendimi, do të bëhet korrigjimi i buxhetit që është pjesë përbërëse (Shtojca 2) e kësaj kontrate.

## Këshillimi dhe trajnimi

### Neni 5

Gjatë zbatimit të projektit, Grantdhënësi do të ofrojë këshillime për përfituesin.

Këshillimi do të ofrohet nga Koordinatori Kombëtar dhe synon të japë këshilla dhe udhëzime për zbatimin e projektit, veçanërisht për metodologjinë e projektit dhe rezultatet e këtij të fundit.

Do të ofrohen seanca këshillimi për përfituesin me qëllim kontribuimin në CS CBA GP (Civil Society Capacity Building and Advocacy Grant Program implementation)

Për përfituesin do të organizohet edhe një seminar njëditor për procedurat e menaxhimit financiar dhe për praktikat e mira të menaxhimit të projektit.

## Njohja/Vizibiliteti

### Neni 6

Përfituesi do të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të promovuar faktin se ky grant është financuar nga Bashkimi Evropian. Këto masa duhet të jenë në përputhje me Manualin e Komunikimit dhe Vizibilitetit të veprimeve të jashtme të Bashkimit Evropian, i cili është botuar nga Komisioni Evropian:

[https://ec.europa.eu/europeaid/visibility/documents/communication\\_and\\_visibility\\_manual\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/europeaid/visibility/documents/communication_and_visibility_manual_en.pdf)

Përfituesi i këtij granti duhet të sigurojë njohjen e këtij projekti nëpërmjet përdorimit të flamurit të Bashkimit Evropian dhe vendosjes së tekstit "Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian". Po ashtu, përfituesi do të përdorë logon zyrtare të Projektit ALTER në të gjitha dokumentet zyrtare, analizat, botimet, raportet dhe aktivitetet, materialet promocionale dhe të printuara, me autorizim paraprak nga Grantdhënësi. Nga ana tjetër, Grantdhënësi do t'i ofrojë përfituesit të gjitha shabllonet e nevojshme të njohjes/vizibilitetit.

Përfituesi është i detyruar të përmendë në raportet e tij të brendshme dhe vjetore si dhe në daljet në media, kur prezantohen rezultatet e këtij granti, se granti i dhënë mbështetet nga BE.

Gjatë promovimit dhe prezantimit të kërkitimit/botimeve nga ky grant, përfituesi duhet të përfshijë këtë deklaratë: "Ky dokument u mundësua me mbështetjen financiare të Bashkimit. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e <përfituesit> dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian."

Përfituesi autorizon Grantdhënësin, Komisionin Evropian, dhe personelin përkatës të caktuar prej tyre, për të publikuar emrin dhe adresën, kombësinë, qëllimin e grantit, afatin dhe vendin e grantit, si dhe shumën maksimale të grantit të marrë nga përfituesi. Nga detyrimi për të publikuar këtë informacion mund të bëhet përjashtim nëse ky publikim rrezikon ose dëmton interesat e përfituesit.

## Operacioni Financiar

### Neni 7

Përfituesi është i detyruar të mbajë llogari të sakta dhe të rregullta në lidhje me zbatimin e aktiviteteve, duke përdorur sistemin e duhur të kontabilitetit me llogari të dubluar.

Llogaritë:

- a) mund të jenë pjesë përbërëse ose ndihmëse e sistemit të rregullt të përdoruesit;

b) duhet të mbahen në përputhje me parimet e kontabilitetit dhe administrimit të llogarive financiare dhe ligjeve në fuqi në vend;

c) duhet të mundësojnë që të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me këtë projekt të ndiqen, identifikohen dhe verifikohen me lehtësi.

Përfituesi është i detyruar të sigurojë që raportet financiare të përcaktuara në Nenin 4 të mund të gjurmohen saktësisht dhe lehtësisht në sistemin e kontabilitetit dhe në dokumentet e tjera përkatëse të financës. Për këtë arsye, përfituesi është i detyruar të përgatisë dhe të bëjë siç duhet rakordimet, planet shtesë, analizën dhe shpërndarjen, inspektimin dhe verifikimin.

## E drejta e aksesit

### Neni 8

Përfituesi duhet të bëjë të mundur verifikimin nga Komisioni Evropian, Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit, Gjykata Evropiane e Auditorëve, dhe auditori i jashtëm i autorizuar nga Grantdhënësi. Përfituesi duhet të marrë të gjitha masat për lehtësimin e punës së tyre.

Përfituesi duhet të lejojë subjektet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni:

- a) Të aksesojnë vendet dhe objektet ku zbatohet projekti;
- b) Të shqyrtojnë sistemet e kontabilitetit dhe informacionit, dokumentet dhe bazat e të dhënave që lidhen me menaxhimin teknik dhe financiar të projektit;
- c) Të marrin kopje të dokumenteve;
- d) Të bëjnë kontrolle në vend;
- e) Të bëjnë një kontroll të plotë të të gjitha të dhënave dhe dokumenteve të llogarisë dhe kontabilitetit që kanë të bëjnë me financimin e Projektit.

Përveç kësaj, përfituesi duhet të lejojë Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit të kryejë kontrolle dhe inspektime në përputhje me procedurat e ligjit të BE-së për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian kundër mashtrimit dhe parregullsive.

Sipas rastit, konstatimet mund të çojnë në rimbursimin e Grantdhënësit.

Aksesi që i mundësohet përfaqësuesit të Komisionit Evropian, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit, Gjykatës Evropiane të Auditorëve, dhe auditorit të jashtëm të autorizuar nga Grantdhënësi për kryerjen e verifikimeve sipas këtij neni bazohet në konfidencialitetin e palëve të treta, në përputhje me detyrimet që lindin nga e drejta publike në fuqi.

Aksesi duhet të bëhet i mundur nga përfituesi edhe në rastin e kryerjes së vlerësimit dhe monitorimit të përkohshëm ose të mëvonshëm nga Komisioni Evropian.

### ***Konfidencialiteti***

### Neni 9

Grantdhënësi dhe përfituesi marrin përsipër përgjegjësinë për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe e identifikuar si konfidenciale deri 5 vjet pas pagesës së bilancit, pavarësisht nëse forma e tyre është me gojë ose me shkrim.

Nëse nuk ka marrë më parë pëlqimin e Grantdhënësit, Përfituesi nuk duhet të përdorë informacionin konfidencial për ndonjë qëllim tjetër përveç përmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

## Mbajtja e dokumentacionit

### Neni 10

Përfituesi duhet të ruajë të gjitha të dhënat, dokumentet e kontabilitetit dhe ato mbështetëse që lidhen me këtë Marrëveshje për 5 vjet pas pagesës së plotë të grantit, si dhe në rastet e auditimit, verifikimit, ankesave, procedurave gjyqësore dhe përmbaruese që janë në vazhdim e sipër.

Dokumentacioni duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm dhe të ruhet në një formë që të jetë e lehtë për kontroll dhe përdoruesi duhet të njoftojë për vendin ku ruhet dokumentacioni.

Të gjitha dokumentet mbështetëse duhet të jenë të disponueshme në formën e tyre origjinale, përfshirë këtu edhe në formatin elektronik.

Përveç raporteve të përcaktuara në Nenin 4, dokumentet që mbulohen nga ky nen janë edhe:

- a) Dokumentet e llogarisë financiare (në format elektronik ose letër) të sistemit të kontabilitetit të Përfituesit, si libri i përgjithshëm, bilancet, urdhrat e pagesave, regjistri i inventarit dhe informacione të tjera të kontabilitetit;
- b) Prova të kryerjes së procedurave të prokurimit, si dokumentacioni i tenderit, ofertat për tender dhe raportet e vlerësimit
- c) Prova të detyrimeve, si kontrata dhe formularë të ngjashëm;
- d) Prova të ofrimit të shërbimit, si raportet e miratuara, formularë me evidenca, fletë-udhëtime, prova të frekuentimit të seminareve, konferencave dhe kurseve të trajnimit (përfshirë këtu dokumentacionin përkatës dhe materialet e marra, certifikatat), etj.
- e) Prova të mallrave të marra, si dërgesat nga furnitorët;
- f) Prova të përfundimit të punëve, si konfirmime të marrjes në dorëzim
- g) Prova të blerjeve, si fatura dhe mandat pagesash
- h) Prova të pagesave, si konfirmim nga banka, njoftim detyrimi, marrëveshje me kontraktorin;
- i) Prova të taksave dhe / ose TVSH që paguhen nuk mund të rikthehen;
- j) Kosto të karburanteve – listë përmbledhëse e distancave të udhëtuara, konsumit mesatar të automjetit të përdorur, kosto për karburant dhe mirëmbajtje;
- k) Raporte të pagesave të stafit, si kontrata, raporte për pagat dhe formularët për regjistrimin e orëve të punës (fletët e punës). Stafi i punësuar: hollësi të pagesave të bëra, të vërtetuara saktësisht nga personi i ngarkuar, koeficienti i zbërthyer i pagave bruto, pagesa të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe paga neto. Për jo-rezidentët: analiza dhe ndarje të kostove të punës sipas muajit, vlerësimet e bazuara në shumat standarde të verifikuara të shpenzuara sipas kohës në koeficientet e llogaritur për pagat bruto, sigurimet shoqërore, siguracionin dhe pagën neto.

## Komunikimi

### Neni 11

Komunikimi zyrtar mes Grantdhënësit dhe përfituesit do të bëhet mes personelit përkatës të Grantdhënësit dhe Personit të Kontaktit të Përfituesit, i përcaktuar si i tillë në këtë kontratë, nëpërmjet adresave elektronike të listuara në këtë Marrëveshje. Komunikimi elektronik midis palëve

të mësipërme do të përbëjë komunikimin zyrtar midis Grantdhënësit dhe përfituesit, përveçse në rastet kur Grantdhënësi shprehimisht përcakton se për çështje të caktuara është i domosdoshëm komunikimi me shkrim.

Çdo komunikim që nuk është në përputhje me dispozitat e këtij neni nuk do të konsiderohet si komunikim zyrtar dhe nuk përbën detyrim për Grantdhënësin.

Grantdhënësi do të japë menjëherë sqarime/përgjigje për të gjitha pyetjet e bëra nga përfituesi.

Për të gjitha çështjet e pazgjidhura gjatë zbatimit të projektit, Përfituesi ka të drejtë të këshillohet dhe të kërkojë mendim nga Grantdhënësi. Brenda dy javëve, Grantdhënësi duhet të ofrojë një zgjidhje racionale. Nëse është e nevojshme, Grantdhënësi mund ta referojë përfituesin të komunikojë me menaxherin e Granteve.

Për të lehtësuar komunikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, Grantdhënësi do të krijojë një llogari virtuale në Dropbox që mund të aksesohet nga të gjithë grantmarrësit. Përfituesi është i detyruar të përdorë këtë mjet në përputhje me udhëzimet e Grantdhënësit.

## Cilësia e rezultateve

### Neni 12

Studimet që janë pjesë përbërëse e objektit të grantit duhet të jenë origjinale dhe të kontribuojnë në arritjen e objektivave të projektit.

Përfituesit duhet të sigurojnë që rezultatet që do të arrihen nga ky projekt të jenë origjinale dhe që nuk zbatohen pjesërisht apo plotësisht si pjesë e një projekti tjetër apo aktiviteteve të tjera.

Rezultatet e grantit do të publikohen në [www.balkan-noborder.com](http://www.balkan-noborder.com) dhe faqen e internetit të organizatave partnere. Grantdhënësi rezervon të drejtën që të propozojë ndryshime dhe përmirësime në metodologjinë e rezultateve të projektit në përputhje me dokumentin e projektit.

Grantdhënësi ka të drejtë të kontrollojë cilësinë e produktit final të projektit.

Përfituesi është i detyruar të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e projektit që lidhen me zbatimin e objektit të grantit, ALTER dhe aktivitetet e tjera të projektit me ftesë të Grantdhënësit.

## Pronësia dhe përdorimi i rezultateve

### Neni 13

Pronësia i takon përfituesit, po ashtu edhe të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale që rrjedhin nga rezultatet e aktiviteteve, raporteve dhe dokumenteve të tjera përkatëse të projektit.

Përfituesi i jep të drejtën Grantdhënësit të përdorë, sidomos të ruajë, ndryshojë, përkthejë, paraqesë, riprodhojë në çdo procedurë teknike, të botojë dhe komunikojë me mediat të gjithë dokumentacionin që prodhohet nga aktivitetet pavarësisht formës, pa pasur nevojë të shkelë të drejtat ekzistuese të pronësisë intelektuale dhe industriale.

Përfituesi merr përsipër të sigurojë të gjitha të drejtat për të qenë në gjendje të përdorë të drejtat ekzistuese të pronësisë intelektuale që janë të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Në rastin e personave fizikë të treguara në fotografi ose video, përfituesi në raportin e fundit të dorëzuar tek Grantdhënësi, duhet të paraqesë deklaratën e këtyre personave ku jepet leje për përdorimin e imazhit të tyre. Ky detyrim nuk aplikohet për fotot dhe videot që janë marrë në vende publike/konferenca si pjesëmarrës/shikues, ose si figura publike në paraqitjet e tyre publike.

## Konflikti i interesit

### Neni 14

Përfituesi do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar çdo lloj situatë që mund të cenojë pavarësinë dhe zbatimin e drejtë të kësaj marrëveshjeje. Konflikte të tilla interesi mund të lindin si pasojë e interesave ekonomike, përkatësisë politike, shtetësisë, lidhjes familjare apo emocionale, ose çdo lloj tjetër marrëdhënieje apo interesi të përbashkët.

Për çdo konflikt interesi që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje duhet të njoftohet menjëherë Grantdhënësi. Në rast konfirmimi të ekzistencës së konfliktit, përfituesi duhet të marrë menjëherë të gjitha hapat e nevojshme për shkarkimin e tij.

Grantdhënësi rezervon të drejtën të verifikojë që masat e marra janë të përshtatshme si dhe të kërkojë marrjen e masave shtesë nëse është e nevojshme.

Përfituesi duhet të sigurojë që stafi i tij, përfshirë këtu edhe zyrtarë të lartë, nuk kanë provokuar asnjë situatë që mund të çojë në konflikt interesi. Kur detyrimet e ndërmarra sipas kësaj kontrate shkelen, përfituesi është i detyruar që të zëvendësojë menjëherë personin pa asnjë kompensim nga Grantdhënësi nëse konstatohet se këtë situatë e ka(në) shkaktuar personi/ personat në fjalë.

## Përgjegjësia

### Neni 15

Grantdhënësi nuk duhet të mbajë asnjë përgjegjësi në asnjë rrethanë dhe për asnjë arsye për lëndim apo dëmtim të shkaktuar ndaj stafit ose pasurisë së përfituesit në zbatimin e projektit, ose si rezultat i aktiviteteve të zbatuara në kuadër të këtij projekti. Prandaj, Grantdhënësi nuk mund të pranojë asnjë pretendim për rritje të kompensimit apo pagesave që lidhen me dëmet apo dëmtimet.

Përfituesi mban përgjegjësi të plotë ndaj palëve të treta, përfshirë këtu edhe përgjegjësinë për dëmin e çdo lloji të shkaktuar nga ana e tij në zbatimin e projektit, ose si rrjedhojë e realizimit të projektit. Përfituesi duhet ta përjashtojë Grantdhënësin nga çdo përgjegjësi që rrjedh nga ndonjë pretendim apo veprim si pasojë e shkeljes së rregullave dhe rregulloreve nga ana e Përfituesit apo e punonjësve të tij ose individëve nën përgjegjësitë e tyre, ose si rezultat i shkeljes së të drejtave të palëve të treta.

### Neni 16

Në rast se kushtet e nevojshme për përdorimin e grantit ndryshojnë apo pushojnë së ekzistuari, si në rastin e gabimeve thelbësore, parregullsive dhe/ose mashtrimeve, përfituesi është i detyruar t'i kthejë grantin Grantdhënësit.



## Zgjidhja e Kontratës

### Neni 17

Nëse vendoset se janë shkelur detyrimet sipas kësaj kontrate apo nëse projekti nuk po zbatohet në përputhje me këtë kontratë, Grantdhënësi ka të drejtë të zgjidhë kontratën.

### Neni 18

Pjesë e kontratës janë edhe Kushtet e Përgjithshme në fuqi në kontratat e granteve të financuara nga BE për aktivitete të jashtme, të cilat i bashkëngjiten kësaj Kontrate.

Detyrimet, taksat dhe tarifat, përfshirë TVSH nuk mbulohen për aktivitetet e mbështetura nga Grantdhënësi dhe nuk do të rimbursohen. Përveç rasteve kur nuk është e mundur të ketë përjashtim të taksave.

## Dispozita përfundimtare

### Neni 19

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje nga ana e përfituesit si palë e kontraktuar.

### Neni 20

Çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim të përbashkët, dhe nëse marrëveshja nuk arrihet, çështja do të zgjidhet nga gjykata kompetente në **XXX**.

### Neni 21

Hartuar në Anglisht në tre (3) kopje origjinale, dy për Grantdhënësin dhe një për përfituesin.

Grantdhënësi

Përfituesi

(Organizata)

Emër mbiemër

Emër mbiemër

Pozicioni

Pozicioni

Personi i kontaktit në emër të Grantdhënësit:

Emri, mbiemri, pozicioni

Adresa

Civil Society Capacity Building and Advocacy Grant Program

Email:

cc:

Personi i kontaktit për Çështjet Financiare të Grantdhënësit

Emri, mbiemri, pozicioni

Adresa

Email:

Personi i kontaktit i Përfituesit:

Emri, mbiemri, pozicioni

Adresa

Email: